

STATUTI
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“LUXURY BRAZILIAN FURNITURE” shpk

Ne mbeshtetje te ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite tregetare”, sot me date 11 Gusht 2020, Asamblea e Ortakeve te Shoqerise Tregetare “LUXERY BRAZILIAN FURNITURE” shpk paraqet Statutin, si vijon:

FORMIMI

1.1 Formimi i shoqerise

Eshte krijuar nga ortaket:

- Riccardo Miglietta, me dokument identifikimi pasaporte YA6068634, leshuar ne Itali,

- Maringlen De Iudicibus, me dokument identifikimi pasaporte YB5648599, leshuar ne Itali,

nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, konform ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare” ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

1.2 Emri

Emri i shoqerise se krijuar eshte “LUXURY BRAZILIAN FURNITURE” shpk.

1.3 Objekti

Qellimi i shoqerise eshte percaktuar ne objektin e Shoqerise, e cila ka si objekt te veprimtarise:

Shërbime komisionere tregtare, tregti me pakice e shumice, import-export te artikujve industriale, etj.

1.4 Zyrat (Selia)

Shoqeria Tregetare “LUXURY BRAZILIAN FURNITURE” shpk ka seline ne Rruga "Hamid Shijaku", Pallati 6, Shkalla 1, Apartamenti 1, Tirane, Shqiperi.

1.5 Afati i Shoqerise

Kohezgjatja e shoqerise do te jete mbi 10 vjet.

1.6 Kapitali

Kapitali themeltar eshte 10,000 leke.

Shoqeria Tregetare “LUXURY BRAZILIAN FURNITURE” shpk ka pjesemarrjes te kapitalit themelues:

- Riccardo Miglietta, me 1 kuote, pjesemarrje 50%, me vlere 5,000 lek,

- Maringlen De Iudicibus me 1 kuote, pjesemarrje 50%, me vlere 5,000 lek.


1.7 Libri i shoqerise

Per te precizuar e per te saktësuar veprimtarine e vet ekonomike, si dhe marredheniet e punes, shoqeria do te mbaje librin e vet, i cili do te quhet Libri i Shoqerise.

Ne kete liber do te mbahen proces-verbalet e:

- te gjitha takimeve te kryera nga Administratoret;

- te gjitha mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme.



1.8 Konfidencialitet

Ortakët për vetë dhe personat e afiluar, janë dakort që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojnë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

1.9 Viti financiar

Bilanci financiar i shoqërisë do të mbyllet me 31 dhjetor të çdo viti. I pari do të jetë 31 dhjetori i vitit 2020.

ARTIKULLI II

TJETERSIMI I KUOTAVE DHE FINANCIMI I SHOQËRISË

2.1 Transferimi i kuotave

Kuotat e shoqërisë mund të transferohen lirisht me rrugë trashëgimie. Pjesët e kapitalit themelor janë lirisht të transferueshme dhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkeshortëve, si dhe mes paraardhësve e pasardhësve, pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e shumicës së ortakeve konform neneve 73,81 dhe 87 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë tregëtare”.

2.2 Financimi i shoqërisë

Financimi i shoqërisë lejohet të bëhet me çdo mënyrë ligjore, me kredi bankare ose forma të ndryshme, sipas miratimit të asamblese konform nenit 81 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë tregëtare”.

ARTIKULLI III

KAPITALI

3.1 Kontributet e kapitalit

Sasia e kapitalit themeltar derdhur sipas depozitës 1.6 të këtij statuti do të quhet KONTRIBUT KAPITALI THEMELUES. Ortakët kanë të drejtë që në të ardhmen, në funksion të këtij kontributi të ndryshojnë edhe vlerën e këtij kapitali themelor sipas modaliteteve të përcaktuara në nenin 81 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë tregëtare”.

3.2 Financimi

Në masën e duhur shoqëria ka të drejtë të sigurojë financim tregtar ose investues nga çdo bankë e huaj apo shqiptare, financim ky që do të rregullohet me anë të kontratave ose të marrëveshjeve të posaçme.

3.3 Llogaria e shoqërisë

Shoqëria do t’i mbaje llogaritë duke u mbështetur tek leku shqiptar.

ARTIKULLI IV

STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

4.1 Qendra e shoqërisë

Shoqëria do të strukturojë fillimisht qendrën e vet. Duke u nisur nga qëllimi i saj, ajo do të konsiderojë këte qendër si SHOQËRI NENE, e cila rast pas rasti do të hapet me anë filialesh ose shoqërish të përbashkëta në të gjitha ato vende ku do të shohe interes në përbushje të qëllimit të saj, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë e jashtë saj.

4.2 Administrimi

Shoqëria “LUXURY BRAZILIAN FURNITURE” shpk do të administrohet nga Administratori Riccardo Miglietta.

Afati kohor i zgjedhjes se Administratorit eshte per nje periudhe pesevjecare, me te drejte rizgjedhjeje.

4.3 Drejtimi i asamblese

Asamblea do te drejtohet nga Asamblea e Pergjithshme Ortakeve.

4.4 Rezidenca e Ortakeve

Per çdo raport qe ka te beje me shoqerine eshte ajo qe rezulton nga Libri i Ortakeve (Libri i Shoqerise).

4.5 Drejtimi i Shoqerise

Organi me i larte i drejtimit te shoqerise do te jete Asamblea e Pergjithshme e Ortakeve. Asamblea do te mblidhet te pakten nje here ne vit.

4.6 Formalitetet e mbledhjes

Asamblea do te mund te mblidhet dhe jashte selise se shoqerise, si brenda dhe jashte territorit te shtetit nen kujdesin e administratorit.

4.7 Perfaqesimi

Administratori i shoqerise ka te drejte te perfaqesoje shoqerine perballe te treteve, ne administrate e ne gjyq.

4.8 Marredheniet

Vendimet e asamblese duhet te jene te rregjistruara ne nje proces verbal, i cili ne te njejten kohe duhet te jete nenshkruar nga administrator, si ne mbledhjet e zakonshme ashtu dhe ne mbledhjet e jashtezakonshme.

ARTIKULLI V

LIBRAT E SHOQERISE, BILANCI, UTILITETET, SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI

5.1 Librat sociale

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacionit kontabel dhe libra te tjere lidhur me aktivitetin e shoqerise:

Librin e proces-verbaleve te mbledhjeve dhe i vendimeve te asamblese.

5.2 Bilanci

Bilanci do te mbyllet ne 31 dhjetor te çdo viti.

5.3 Utilitete

Fitimi neto i bilancit shperndahet si vijon:

5% destinohet per te krijuar fondin e rezerves se thjeshte deri sa ku te mberrije ne nje te tretien e kapitalit social, ose aq sa, sipas percaktimeve qe do te behen ne statut me ane amendamentesh.

5.4 Shperndarja dhe likuidimi

Ne rastet e shperndarjes se shoqerise, administratoret parashikojne emerimin e nje ose disa likuidatoreve, te cileve u percaktohen fuqite.

ARTIKULLI VI

DISPOZITAT E FUNDIT

6.1 Shtimi i ortakeve

Kur ortaket bien dakort te bejne shtese kapitali me ane te personave te trete, qe keta te konsiderohen ortak duhet te veprohet keshtu:

Se pari, me vendim unanim nga Asamblea ku shenohet emri i plote dhe kuotat e kapitalit qe do te derdhe ortaku i ardhshem;

Se dyti, behet regjistrimi ne librin e ortakeve ku shenohet emri i plote dhe kuota e kapitalit qe do te derdhe;

Se treti, veprimi i bashkimit te ortakut te ri duhet te behet me akt noterial.

6.2 Klauzole kompromisi

Per çdo konflikt qe mund te lind ortakët e kesaj shoqerie (ose trashegimtaret e tyre), mund t'i drejtohen Gjykates shqiptare e te pranohet si kompetente per kete, konform legjislacionit shqiptar. Per rregjistrimin e Shoqerise prane QKB-se caktohet ortaku dhe Administratori i shoqerise Riccardo Miglietta.

6.3 Amendamentet

Ketij statuti mund t'i behen amendamente sa here qe Asamblea e Pergjithshme e Ortakeve e sheh te arsyeshme.

ORTAKET E SHOQERISE TREGETARE

“LUXURY BRAZILIAN FURNITURE” shpk

Riccardo Miglietta

Maringlen De Iudicibus

